

20260110184

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 1

Në Ligjin e Sistemit të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 209/23), në nenin 3, në paragrafin (1), fjalët: “fëmijët dhe” dhe “Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve” fshihen.

(2) Pas paragrafit (2), shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), të cilët vijnë:

“(3) Dispozitat e këtij ligji, që i referohen licencimit të personave profesionistë, që kryejnë vlersimin, metodologjinë kombëtare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, shqyrtimin profesional gjatë revizionit të vlerësimeve dhe Regjistrin e Personave me Aftësi të Kufizuara, zbatohen edhe në vlerësimin funksional që kryhet nga Shërbimi i Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor – Shtëpia e Shëndetit - Shkup”.

(4) Mënyra e zbatimit të Metodologjisë Kombëtare të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar dhe futja e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në Regjistrin e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Shërbimi i Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor - Shtëpia e Shëndetit – Shkup mënyra e kryerjes së shqyrtimit nga ekspertët gjatë revizionit të vlerësimeve në sistemin e vlerësimit funksional, mënyra e qasjes dhe marrjes së dokumentacionit mjekësor të nevojshëm për të përcaktuar aftësinë e kufizuar të personit nga Sistemi Kombëtar për Regjistrat Elektronikë Shëndetësorë, si dhe mënyra e koordinimit dhe bashkëpunimit të autoriteteve dhe institucioneve kompetente në sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe sistemin e vlerësimit funksional përcaktohen nga ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve (në tekstin e mëtejshëm: Ministri) në bashkëpunim me ministrin e Shëndetësisë.”.

Neni 2

Në nenin 4, pika 1, pas fjalës “mosdiskriminim”, vendoset një presje dhe shtohen fjalët “si dhe sigurimi i qasjes dhe akomodimit të arsyeshëm në të gjitha fazat e procedurës”.

Në pikën 4, pas fjalës “aftësi e kufizuar”, shtohen fjalët: “si dhe sigurimi i pjesëmarrjes aktive dhe pëlqimit të personit, duke përfshirë të drejtën për një shoqërues”.

Në pikën 8, lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 9, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën “dhe”

Pas pikës 9, shtohet një pikë e re 10, e cila thotë:

“10. Llogaridhënia dhe transparenca e organeve dhe profesionistëve të përfshirë që kryejnë vlerësime të aftësisë së kufizuar.”.

Neni 3

(1) Në nenin 4, pika 1, pas fjalës: “mosdiskriminim”, shtohen fjalët: “si dhe sigurimi i aksesueshmërisë dhe akomodimit të përshtatshëm në të gjitha fazat e procedurës”.

Neni 4

Në nenin 7, paragrafi (2), fjalët “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët “Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve”.

Neni 5

Në nenin 8, paragrafi (1) ndryshohet dhe thotë:

“Ministria lidh marrëveshje ose memorandum bashkëpunimi me Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut i cili rregullon mënyrën se si profesionistët që kryejnë vlerësimin dhe janë të punësuar nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut kryejnë vlerësime brenda kornizës së sistemit për vlerësimin e aftësisë së kufizuar”.

Neni 6

Në nenin 9, në paragrafin (1), fjalët: “punonjës ose” fshihen.

Neni 7

Në nenin 11, në paragrafin (1) fjalët: “për punë dhe politikë sociale (në tekstin e mëtejme: Ministri)”, fshihen.

Neni 8

Në nenin 17, paragrafi (4), pas fjalëve “zbatimi i” shtohen fjalët: “programi i trajnimit për profesionistët që kryejnë vlerësime dhe”.

Neni 9

Në nenin 18, paragrafi (3), pas fjalëve: “për trajnues” vendoset presje dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Neni 10

Në nenin 22, paragrafi (1), fjalët: “Ministria, Institucioni Publik Enti i Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup” zëvendësohen me fjalët: “Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut”.

Neni 11

Në nenin 24, paragrafi (1), fjalët: “Ministria, Institucioni Publik Enti i Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup” zëvendësohen me fjalët “Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë së Veriut”.

Paragrafi 2 ndryshohet dhe vijon:

“Profesionisti që kryen vlerësimin në paragrafin (1) të këtij neni duhet të ketë qasje të autorizuar në dokumentacionin mjekësor të nevojshëm për të përcaktuar aftësinë e kufizuar të personit dhe mundësinë për marrjen nga Sistemi Kombëtar për evidencën elektronike në shëndetësi.

Pas paragrafit (5), shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7), të cilët vijnë:

“(6) Të gjitha njoftimet nga Ministria për kërkuesin të ofrohen në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe, sipas nevojës ose kërkesës, në një format të aksesueshëm.

(7) Ministria siguron komunikim elektronik dypalësh dhe monitorim të lëndës nëpërmjet qasjes së TIK-interfejs”.

Neni 12

Në nenin 27, paragrafi (2) ndryshohet dhe vijon:

“Metodologjia kombëtare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar bazohet në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF), Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe praktikat më të mira e cila përqendrohet në shëndetin dhe gjendjet shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara, si dhe në funksionalitetin, ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e tyre në komunitet”.

Paragrafi (4) ndryshohet dhe vijon:

“Metodologjia Kombëtare e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar miratohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Ministrisë, të zhvilluar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.”

Neni 13

Në nenin 28, paragrafi (1), fjalët: “mjekësisht funksionale” zëvendësohen me fjalën “biopsikosociale”, dhe pas fjalës “dokumentacion” shtohen fjalët: “dhe funksionimi, mbështetja e nevojshme dhe barrierat e mjedis”.

Në paragrafin (2), pas pikës shtohet një fjali e re e cila vijon: “Personi që vlerësohet ka të drejtë për një shoqërues, një interpretueses të gjuhës së shenjave, materiale në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe akomodime të tjera pa shpenzime shtesë”.

Neni 14

Në nenin 33, pika 2, pas fjalëve “shpenzime për” shtohen fjalët: “vizita trajnuese dhe”.

Neni 15

Në nenin 34, në paragrafin (4) nënpika 5.3 fshihet.

Neni 16

Në nenin 35, paragrafi (9), pas fjalës "dorëzojnë" shtohen fjalët: “ose mundësoj marrjen e”.

Neni 17

Shërbimi i Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor – Shtëpia e Shëndetit Shkup do të themelohet dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes Shëndetësore dhe Ligjin e Mbrojtjes Sociale, brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Prona, pajisjet, mjetetet, arkivat dhe dokumentacioni tjetër që Institucioni Publik, Enti i Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup i ka marrë përsipër nga Shërbimi i Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor – Shtëpia e Shëndetit Shkup i transferohen Shërbimit të Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor - Shtëpia e Shëndetit Shkup, brenda 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Punonjësit e Institucionit Publik Enti i Rehabilitimit të Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup, të cilët, si ekspertë, kryejnë vlerësime funksionale deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të merren në përgjegjësi nga Shërbimi i Vlerësimit Funksional në Institucionin Publik Shëndetësor – Shtëpia e Shëndetit Shkup, brenda 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18

Punonjësit e Ministrisë të cilët, si ekspertë, vlerësojnë personat me aftësi të kufizuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të merren në përsipër nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut, brenda 15 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 19

Personat që kanë marrë një certifikatë të trajnimit të përfunduar për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe kanë kaluar një provim profesional të organizuar nga Ministria në kuadër të Projektit të Administrimit të Sigurimit Social, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar që brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesë një kërkesë në Ministri për marrjen e licencës për person profesional që kryen vlerësim.

Ministria, brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshon licencë për profesionistin që kryen vlerësim, nëse personi në paragrafin (1) të këtij neni i plotëson kushtet e nenit 10, paragrafi (1), pikat 1, 2 dhe 3 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Sistemit të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 209/23).

Personave në paragrafin (1) të këtij neni, të cilët nuk paraqesin kërkesë për marrjen e licencës për person profesional që kryen vlerësim brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni ose të cilët nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 10 paragrafi (1) pikat 1, 2 dhe 3 dhe paragrafin (2) të Ligjit të Sistemit të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 209/23), nuk do t’u lëshohet licencë për një person profesional që kryen një vlerësim.

Neni 20

Aktet nënligjore të parashikuara nga ky ligj do të miratohen brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 21

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.